



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI  
ENERGY REGULATORY OFFICE  
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

**Shqyrtimi i Katërt i Tarifave të Energjisë Elektrike 2010 (SHTE4)**  
**Shqyrtimi i komenteve, përgjigjet dhe propozimi i ZRrE-së**

**Prishtinë, 18 mars 2010**

## Përmbajtja

<b>1</b>	<b>Hyrje .....</b>	<b>2</b>
<b>2</b>	<b>Komentet e Korporatës Energjetike të Kosovës .....</b>	<b>2</b>
<b>3</b>	<b>Përgjigjet e ZRrE-së rreth komenteve të Korporatës Energjetike të Kosovës sh.a. ....</b>	<b>3</b>
3.1	Korrigjimet e RAB-it dhe të RAB <sub>r</sub> -it .....	3
3.2	Çmimi i lejuar i importit.....	3
3.3	Sasia e lejuar e importit emergjent .....	4
3.4	Kostoja e lejuar për KOSTT-in .....	4
3.5	Borxhet e këqija.....	5
3.6	Kontrata për blerjen e shërbimeve ndihmëse.....	5
3.7	Kostoja e blerjes së energjisë nga Hidrocentralet .....	5
3.8	Përshtatjet e ZRrE-së .....	6
<b>4</b>	<b>Komentet e Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe të Tregut të Kosovës (KOSTT) .....</b>	<b>8</b>
<b>5</b>	<b>Përgjigjet e ZRrE-së për komentet e KOSTT-it .....</b>	<b>8</b>
5.1	Shpenzimet shtesë për pagat e bazuara në performansë.....	8
5.2	Kostoja e mirëmbajtjes.....	8
5.3	Niveli i kostove të KOSTT-it në raport me operatorët e tjerë në regjion .....	9
<b>6</b>	<b>Komentet e Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave.....</b>	<b>9</b>
<b>7</b>	<b>Komentet e Shoqatës së Ujësjellësve të Kosovës (SHUKOS) .....</b>	<b>9</b>
<b>8</b>	<b>Komentet e Shoqërisë Civile .....</b>	<b>10</b>
<b>9</b>	<b>Propozimet e ZRrE-së .....</b>	<b>10</b>
9.1	Aneksi 1: Tarifat e Rregulluara me pakicë .....	11
9.2	Aneksi 2: Ngarkesat e KOSTT-it .....	12

## 1 Hyrje

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRÉ) është në procesin e Shqyrtimit të Katërt të Tarifave të Energjisë Elektrike (SHTE4). Shqyrtimi i Tarifave nënkupton vlerësimin e të Hyrave të Lejuara të Korporatës Energjetike të Kosovës Sh.a. (KEK) dhe të Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe të Tregut të Kosovës Sh.a. (KOSTT) që duhet të mblidhen nga tarifat e energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar.

Në harmoni me parimet dhe orarin e Shqyrtimit Tarifor, KEK-u dhe KOSTT-i i kanë dorëzuar në ZRRÉ aplikacionet e tyre për të Hyrat e Lejuara dhe Tarifat të cilat pritet të hyjnë në fuqi nga data 1 prill 2010. Më datën 26 shkurt 2010, ZRRÉ-ja ka publikuar Raportin Konsultativ i cili përmban qëndrimet e ZRRÉ-së mbi aplikacionet e KEK-ut dhe të KOSTT-it, si dhe propozimet e saj për të Hyrat e Lejuara dhe Tarifat që janë të nevojshme për funksionimin normal të afarizmit të këtyre entiteteve. Raporti Konsultativ kishte për qëllim marrjen e komenteve eventuale nga palët e interesit për qëndrimet e ZRRÉ-së ndaj aplikacioneve të tyre.

Komente rreth Raportit Konsultativ janë dhënë nga palët:

- Korporata Energjetike e Kosovës sh.a.
- Operatori i Sistemit, Tregut dhe i Transmisionit të Kosovës sh.a.
- Ministria e Ekonomisë dhe e Financave (MEF)<sup>1</sup>
- Shoqata e Ujësjetësve të Kosovës (SHUKOS)
- Organizata jo qeveritare “Konsumatori”
- Organizata jo qeveritare “Fol”

**Ky dokument paraqet përgjigjet dhe qëndrimet e ZRRÉ-së pas shqyrtimit të komenteve dhe propozimet e fundit që do t'i dorëzohen Bordit të ZRRÉ-së për aprovim.**

## 2 Komentet e Korporatës Energjetike të Kosovës

Komentet e KEK-ut janë fokusuar në këto çështje:

- Korrigjimi i ZRRÉ-së i Bazës së Rregulluar të Aseteve (RAB) dhe i Bazës së Rregulluar të Aseteve të financuara komercialisht (RAB<sub>f</sub>)
- Çmimi i lejuar i importit
- Sasia e lejuar e importit emergjent

---

<sup>1</sup> Komenti i MEF-it ka arritur në ZRRÉ më 12 mars 2010, pas afatit (5 mars 2010) të paracaktuar në parimet dhe orarin e SHTE4.

- Kostoja e lejuar për KOSTT-in
- Borxhet e këqija
- Kontrata në mes të KEK-ut dhe KOSTT-it për blerjen e shërbimeve ndihmëse
- Kostoja e blerjes së energjisë nga Hidrocentralet
- Korrigjimet dhe përshtatjet e ZRrE-së

### 3 Përgjigjet e ZRrE-së rreth komenteve të Korporatës Energjetike të Kosovës sh.a.

#### 3.1 Korrigjimet e RAB-it dhe të RAB<sub>f</sub>-it

Gjatë hartimit të Raportit Konsultativ, ZRrE-ja kishte korrigjuar RAB-in dhe RAB<sub>f</sub>-in në aplikacionin e KEK-ut, duke i bashkërenditur vlerat e tyre me vlerat e investimeve kapitale të paraqitura në Pasqyrat Financiare të audituara të KEK-ut.

Me qëllim të transparencës, ZRrE-ja i ka dërguar<sup>2</sup> KEK-ut dy dokumente në të cilat sqarohen llogaritjet e ZRrE-së, të RAB-it dhe të RAB<sub>f</sub>-it, si dhe ndikimet e këtyre llogaritjeve në të Hyrat e Lejuara të KEK-ut për vitin 2010. Pas dërgimit të këtyre dokumenteve, ZRrE-ja i ka ofruar mundësi KEK-ut që të takohet me ZRrE-në në mënyrë që të japë mendimin e saj për llogaritjet e ZRrE-së. Në takimin e mbajtur<sup>3</sup>, zyrtarët e KEK-ut kanë deklaruar se pajtohen me llogaritjet e ZRrE-së dhe se nuk kanë ndonjë koment për këto llogaritje.

Megjithatë, në komentet e dorëzuara pas publikimit të Raportit Konsultativ, KEK-u deklaroi se pas shqyrtimit të mëtutjeshëm të llogaritjeve të ZRrE-së, kanë vërejtur se këto llogaritje nuk kanë marrë parasysh “avanset për furnizuesit”. KEK-u konsideron se “avanset për furnizuesit” duhet të përfshihen në RAB dhe në RAB<sub>f</sub> që zbatohet për llogaritjen e të Hyrave të Lejuara pasi që këto blerje kanë të bëjnë me investime kapitale.

ZRrE-ja thekson se në parim nuk është e drejtë që t’i kthehet llogaritjeve për të cilat palët (KEK-u dhe ZRrE-ja) tanimë ishin pajtuar. Si do që të jetë, rreth këtij komenti ZRrE-ja thekson se “avanset për furnizues” do të rezultojnë në shtesa të aseteve kapitale të cilat janë regjistruar në vitin 2009 nga KEK-u. Këto shtesa janë marrë parasysh ngase ZRrE-ja ka përfshirë shpenzimet e realizuara kapitale të KEK-ut në vitin 2009 në RAB-in dhe në RAB<sub>f</sub>-in e vitit 2010, i cili më tutje është përdorur për të llogaritur të Hyrat e Lejuara nën ETR4. Për këtë arsye, ky koment i KEK-ut nuk ndikon në ndryshimin e propozimit të ZRrE-së.

#### 3.2 Çmimi i lejuar i importit

Lidhur me propozimin e ZRrE-së për çmimin e lejuar për blerjen e energjisë nga importi (69.5 €/MWh), KEK-u ka komentuar se, pasi që ky është çmim i parashikuar për të ardhmen, është vështirë

<sup>2</sup> E-maili i dërguar më datën 16 shkurt 2010.

<sup>3</sup> Takimi I mbajtur më 18 shkurt, 2010 në ZRrE.

të mbrohet ndryshimi në mes të propozimeve të KEK-ut (71.1 €/MWh) dhe të ZRrE-së që ndryshon për vetëm 2.3%.

ZRrE-ja e konsideron komentin e KEK-ut si koment të përgjithshëm dhe jo si qëndrim të KEK-ut për ndryshim të propozimit të ZRrE-së, andaj nuk e sheh të arsyeshme që të komentohet më tepër për këtë çështje.

### **3.3 Sasia e lejuar e importit emergjent**

Lidhur me propozimin e ZRrE-së për sasinë e lejuar të importeve emergjente, KEK-u ka komentuar se është e nevojshme që KEK-u të informohet më shumë për supozimet e ZRrE-së. KEK-u po ashtu ka keqkuptuar qëndrimin e ZRrE-së për furnizimin me energji të kategorive A, B dhe C të konsumatorëve.

ZRrE-ja ka zvogëluar çmimin e supozuar për kontrata për importe emergjente 72-orëshe si dhe vëllimin e kontratave të importeve emergjente 6- orëshe në mënyrë që të reflektojë më mirë çmimet e kontratave të realizuara më parë për koston e blerjes së importit dhe për koston e blerjes së importit emergjent. Korrigjimi i detajuar, si dhe aspektet e tjera të llogaritjes së koston së importit, i janë dërguar KEK-ut përmes e-mailit të datës 2 mars 2010.

Sa i përket furnizimit me energji të kategorive A, B dhe C, ZRrE-ja ka theksuar në Raportin Konsultativ se vlera prej 10.2 milion eurosh për blerjen e energjisë nga importi në raste emergjente ka kuptim vetëm nëse kjo energji do të përdorej për të furnizuar në mënyrë jo diskriminuese të gjitha kategoritë A, B dhe C të konsumatorëve. Propozimi i KEK-ut për furnizim 24:0 të kategorive A dhe B do t'i ofronte KEK-ut mundësi që kategorinë C ta reduktojë në mënyrë jo proporcionale, për t'i krijuar parakushtet për furnizim të pandërprerë për kategoritë A dhe B. Meqë në Bilancin Energjetik në aplikacionin e KEK-ut parashihet një deficit prej 30 GWh në vit, ZRrE propozon që kjo sasi e energjisë të reduktohet sipas nevojës duke respektuar planin ABC në fuqi. KEK-u gabimisht e ka interpretuar këtë qëndrim të ZRrE-së duke thënë se furnizimi i kategorive A dhe B duhet të reduktohet në nivelin e furnizimit të kategorisë C që nuk qëndron.

### **3.4 Kostoja e lejuar për KOSTT-in**

Lidhur me koston e lejuar për shërbimet e KOSTT-it, KEK-u ka komentuar në mes tjerash se të Hyrat e Lejuara të ZRrE-së për këtë kategori kostosh prej €12,497,000 janë nënvlerësuar për €7,828,000 euro. Komenti i KEK-ut është bazuar në supozimin e tyre mbi të Hyrat e Lejuara që KOSTT-i do të përfitonte sikur tarifat e tanishme të KOSTT-it të mbeteshin në fuqi.

ZRrE-ja thekson se në llogaritjet e tyre, KEK-u ka marrë parasysh vlerën e të Hyrave të Lejuara për KOSTT-in (12,497,000 euro) që nuk përfshinë Humbjet e Lejuara në rrjetin e transmisionit. ZRrE-ja kishte theksuar në Pikën 5 të Raportit Konsultativ se të Hyrat e Lejuara të KEK-ut prej 156.2 milion euro përfshijnë edhe 18.1 milion euro të lejuara për KOSTT-in. Sigurisht se ZRrE-ja do të ndryshojë ngarkesat e KOSTT-it për të reflektuar të Hyrat e Lejuara prej 18.1 milion euro.

### 3.5 Borxhet e këqija

Në komentet e dërguara, KEK-u ka ofruar një përshkrim të qëndrimit të ZRrE-së lidhur me borxhet e këqija. ZRrE-ja ka vazhduar të aplikojë parimin e vendosur në Metodologjinë Tarifore, që borxhet e këqija të mos përfshihen në të Hyrat e Lejuara të KEK-ut. Propozimi i ZRrE-së bazohet në parimin se konsumatorët që paguajnë rregullisht nuk duhet të mbulojnë borxhet e konsumatorëve që nuk paguajnë.

ZRrE-ja do të rishqyrtojë qasjen e saj ndaj borxheve të këqija në të ardhmen, në pajtueshmëri me praktikata e zakonshme ndërkombëtare të trajtimit të këtyre borxheve.

### 3.6 Kontrata për blerjen e shërbimeve ndihmëse

Në Raportin Konsultativ, ZRrE-ja ka supozuar<sup>4</sup> se kontrata për shërbime ndihmëse e nënshkruar në mes të KEK Gjenerimit dhe KOSTT-it do të hyjë në fuqi nga janari i vitit 2010. Në komentet e tyre, KEK-u ka këshilluar se kjo kontratë pritet të hyjë në fuqi më vonë në vitin 2010. Ndërkohë, KOSTT-i ka konfirmuar se do të vazhdojë të blejë shërbime ndihmëse nga shtetet fqinje.

Lidhur me këtë koment të KEK-ut, ZRrE-ja do t'i lejojë KOSTT-it të mbajë shumën e lejuar për blerjen e shërbimeve ndihmëse, duke supozuar se kostot e blerjes së shërbimeve ndihmëse nga shtetet fqinje janë përafërsisht të barabarta me kostot e blerjes së këtyre shërbimeve të paraqitura në kontratën me KEK-un.

Njëkohësisht, ZRrE-ja nuk do të ndryshojë të Hyrat e Lejuara të KEK-ut në këtë shqyrtim tarifor, për arsye se nuk dihet saktësisht data e fillimit të zbatimit të kontratës për shërbime ndihmëse. ZRrE-ja do të bashkërendisë të Hyrat e Lejuara të KEK-ut në vitin 2011 për të kompensuar vonesën në pagesa si pasojë e vonesës së zbatimit të kontratës. Ky korrigjim do të marrë parasysh datën e fillimit të zbatimit të kontratës. Për shembull, nëse kontrata fillon të zbatohet më 1 prill të vitit 2010 atëherë KEK-u do të kompensohet në vitin 2011 për 25% (3 nga 12 muajt e vitit) të vlerës së kontratës.

### 3.7 Kostoja e blerjes së energjisë nga Hidrocentralet

Lidhur me koston e blerjes së energjisë nga hidrocentralet, KEK-u nuk është pajtuar me zbritjen e ZRrE-së prej 0.237 milion euro për korrigjimin e blerjes së energjisë nga hidrocentralet e vogla. Sipas KEK-ut, ZRrE-ja duhet të rrisë koston e lejuar për blerjen e energjisë nga hidrocentralet për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), pasi që KEK-u paguan edhe TVSH-në kur blenë energjinë nga ky hidrocentral. KEK-u po ashtu ka theksuar se kostoja e blerjes së energjisë nga HC Ujmani është 27.5 €/MWh dhe jo 24.0 €/MWh siç është propozuar nga ZRrE-ja.

ZRrE thekson se gjatë llogaritjes së të Hyrave të Lejuara në Tabelën 1 të Raportit Konsultativ është marrë për bazë vlera e koston së blerjes së energjisë nga Lumbardhi e paraqitur në modelin tarifor të KEK-ut. Kjo vlerë në modelin e KEK-ut është paraqitur si 50 €/MWh. ZRrE-ja ka konstatuar se çmimi i blerjes së energjisë në Marrëveshjen për Blerjen e Energjisë (MBE) të nënshkruar në mes të HC

---

<sup>4</sup> Në pikën 2 të kontratës për blerjen e shërbimeve ndihmëse të nënshkruar në mes të KEK-ut dhe KOSTT-it thuhet se kontrata hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të saj, e që në këtë rast është 25 janari i vitit 2010.

Lumbardhit dhe KEK-ut është 40 €/MWh dhe ka korrigjuar aplikacionin e KEK-ut për të reflektuar këtë ndryshim.

Kostoja e blerjes së energjisë nga HC Ujmani është paraqitur nga KEK-u si 27.5 €/MWh në format e shabllonizuara të ZRrE-së dhe 24.0 €/MWh në modelin e KEK-ut, që do të thotë se janë paraqitur dy vlera të ndryshme për të njëjtën energji. Në vlerësimin e të Hyrave të Lejuara të paraqitura në Raportin Konsultativ, ZRrE-ja ka marrë parasysh çmimin 24.0 €/MWh për arsye se ky është çmimi i vitit të kaluar dhe ZRrE-ja nuk është njoftuar për ndonjë ndryshim të kushteve të furnizimit në mes të KEK-ut dhe HC Ujmanit. Në ndërkohë, pas publikimit të Raportit Konsultativ, KEK-u ka dërguar në ZRrE MBE-në në mes të KEK-ut dhe HC Ujmanit, me çmim prej 27.5 €/MWh.

Megjithatë, ZRrE-ja do të azhurnojë koston e blerjes së energjisë nga HC Ujmani për të reflektuar rritjen e koston së blerjes së energjisë nga ky hidrocentral sipas kontratës së lartpërmendur. Ky korrigjim i ZRrE-së ndikon që të Hyrat e Lejuara të KEK-ut të rriten për 0.216 milion euro, që nuk paraqet ndryshim substancial që do të ndryshonte propozimin e ZRrE-së për tarifat përfundimtare.

Sa i përket komentit të KEK-ut për TVSH-në, kjo është kosto që në fund faturohet bashkë me energjinë të konsumatori, prandaj nuk është e lejueshme që konsumatori të ngarkohet dy herë me TVSH.

### **3.8 Përshtatjet e ZRrE-së**

Në komentet e dorëzuara, KEK-u ka kërkuar që ZRrE-ja të ofrojë dokumente shtesë për llogaritjet e detajuara të korrigjimeve dhe përshtatjeve të bëra në të Hyrat e Lejuara.

Gjatë shqyrtimit të tretë të tarifave të energjisë elektrike (SHTE3), ZRrE-ja ka lejuar zhvlerësim dhe kthim të lejuar për investimet kapitale të propozuara nga KEK-u në vlerë prej 129.1 milion euro. Vlera e kthimit të lejuar dhe zhvlerësimit të përfshirë në të Hyrat e Lejuara të SHTE3 që korrespondon me nivelin e lartpërmendur të investimeve kapitale është 11.3 milion euro. Gjatë SHTE4, ZRrE-ja ka rishikuar vlerat e investimeve kapitale të realizuara, dhe ka vërejtur se gjatë SHTE3 KEK-u ka investuar vetëm 105.7 milion euro, që korrespondon me 9.2 milion euro kthim të lejuar dhe zhvlerësim. Për këtë arsye, ZRrE-ja ka bashkërenditur ndryshimin në mes të vlerës së lejuar dhe asaj të realizuar të kthimit dhe zhvlerësimit që ka rezultuar me zbritje prej 2.2 milion euro nga të Hyrat e Lejuara të KEK-ut në kuadër të SHTE4.

Bashkërenditjet e ZRrE-së janë dhënë në tabelën në vijim:

Korporata Energjetike e Kosoves - Azhustimet							
			Minierat	Gjenerimi	Distribucion	Furnizimi	AQ
<b>Shpenzimet Kapitale</b>							
	Lejuara (Donacionet)	€000	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	Aktuale (Donacionet)	€000	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	Lejuara (Financim tjetër)	€000	91,800.0	16,600.0	18,000.0	210.0	2,539.0
	Aktuale (Financim tjetër)	€000	78,900.0	16,200.0	8,600.0	210.0	1,800.0
<b>Zhvlerësimi</b>							
	Jetëgjatësia	vite	35.0	16.0	30.0	5.0	5.0
	Lejuar	€000	1,311.4	518.8	300.0	21.0	253.9
	Aktuale	€000	1,127.1	506.3	143.3	21.0	180.0
	Azhustimi	€000	-184.3	-12.5	-156.7	0.0	-73.9
<b>Kthimi</b>							
	MPKK		13.8%	13.8%	13.8%	13.8%	13.8%
	Lejuar	€000	6,334.2	1,145.4	1,242.0	14.5	175.2
	Aktuale	€000	5,444.1	1,117.8	593.4	14.5	124.2
	Azhustimi	€000	-890.1	-27.6	-648.6	0.0	-51.0
Gjithsej		€000	-1,074.4	-40.1	-805.3	0.0	-124.9
<i>Norma e Interesit</i>			8.15%	8.15%	8.15%	8.15%	8.15%
<b>Gjithsej pas Normës së Interesit</b>		€000s	-1,161.9	-43.4	-870.9	0.0	-135.1

Tabela 1

KEK-u po ashtu nuk është pajtuar me propozimin e ZRrE-së që niveli i lejuar i humbjeve teknike në vitin 2010 në rrjetin e distribucionit të jetë 17.1%, që poashtu është vlera e lejuar e këtyre humbjeve në vitin 2009. KEK-u ka kërkuar që vlera e humbjeve teknike të jetë 17.5% për vitin 2010, dhe ka raportuar se humbjet teknike aktuale të vitit 2009 ka qenë 18%. Sipas KEK-ut, nevojitet një kohë më e gjatë që përmirësimet në rrjetin e distribucionit të kenë efekt në uljen e humbjeve, dhe se propozimi i ZRrE-së për uljen e nivelit të humbjeve teknike është i lartë.

ZRrE-ja është e vetëdijshme se nevojitet një kohë e caktuar që të hetohet zvogëlimi i humbjeve në rrjetin e distribucionit, si efekt i investimeve kapitale. Megjithatë, duke pasur parasysh faktin se niveli i realizuar i humbjeve teknike në vitin 2008 ka qenë 17.1%, dhe dinamikën e investimeve kapitale në rrjetin e distribucionit gjatë viteve 2009 dhe 2010, ZRrE-ja e konsideron të paarsyeshme kërkesën e KEK-ut për rritjen e nivelit të lejuar të humbjeve teknike<sup>5</sup>. Tabela 2 paraqet nivelin e humbjeve teknike dhe komerciale të lejuara nga ZRrE-ja dhe të realizuara nga KEK-u.

<sup>5</sup> Niveli i lejuar i humbjeve komerciale për vitin 2010 (20%) korrespondon me nivelin e kërkuar në aplikacionin e KEK-ut për të njëjtin vit (20%)



	2008 Lejuar	2008 Realizuar	2009 Lejuar	2009 Realizuar	2010 Lejuar
Humbjet Teknike në Distribucion	17.4%	17.1%	17.1%	18.0%	17.1%
Humbjet Komerciale në Distribucion	20.0%	25.9%	20.0%	24.8%	20.0%
Gjithsejtë humbjet	37.4%	43.0%	37.1%	42.8%	37.1%

Tabela 2

Siç mund të shihet nga tabela, humbjet teknike të realizuara të KEK-ut kanë qenë 17.1% në vitin 2008. Duke pasur parasysh këtë, ZRrE-ja konsideron se është e arsyeshme që të supozohet se KEK-u mund të arrijë të njëjtin nivel të humbjeve sërish në vitin 2010, pasi që gjatë kësaj kohe do të reflektohet edhe përmirësimi i rrjetit të distribucionit, si efekt i investimeve kapitale të realizuara në vitet e mëparshme.

#### 4 Komentet e Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe të Tregut të Kosovës (KOSTT)

Komentet e KOSTT-it reflektojnë çështjet në vijim:

- Shpenzimet shtesë për pagat e bazuara në performansë
- Kostot e mirëmbajtjes
- Nivelin e kostove të KOSTT-it kundrejt operatorëve të tjerë në regjion

#### 5 Përgjigjet e ZRrE-së për komentet e KOSTT-it

##### 5.1 Shpenzimet shtesë për pagat e bazuara në performansë

Në Raportin Konsultativ, ZRrE-ja ka propozuar të mos lejojë vlerën e kërkuar nga KOSTT-i prej 0.131 milion euro për pjesën e pagave të bazuara në performansë.

Lidhur me këtë qëndrim të ZRrE-së, KOSTT-i ka komentuar se beson fuqishëm në nevojën për stimulimin e punëtorëve për përmirësimin e vazhdueshëm në sistemin e transmisionit në Kosovë.

ZRrE-ja pajtohet me qëndrimin e KOSTT-it se është e nevojshme të stimulohen punëtorët në mënyrë që të ketë përmirësime të mëtutjeshme në sektorin e energjisë në Kosovë. Megjithatë, ZRrE-ja thekson se performansa e përmirësuar do të rezultonte në rritjen e profitit për KOSTT-in. Për këtë arsye, pagesat e performansës duhen financuar nga rritja e profitit dhe jo nga konsumatorët si kosto shtesë.

##### 5.2 Kostoja e mirëmbajtjes

KOSTT-i nuk është pajtuar me trajtimin e ZRrE-së të kostos së mirëmbajtjes të paraqitur në Raportin Konsultativ. Në këtë raport ZRrE-ja ka propozuar që pjesa e aseteve e cila është financuar nga shpenzimet operative të mirëmbajtjes të fshihet nga RAB-i dhe RAB<sub>F</sub>-i (në bazë të së cilave llogaritet

zhvlerësimi dhe kthimi i lejuar) në mënyrë që të shmanget llogaritja e dyfishtë e kostove të të njëjtës kategori. KOSTT-i propozon që pjesa e aseteve të mirëmbajtjes të hiqet vetëm nga RAB<sub>F</sub>-i por jo edhe nga RAB-i.

ZRrE-ja vazhdon të qëndrojë pranë propozimit të saj që kjo kategori e kostove të eliminohet tërësisht nga të dy bazat e rregulluara të aseteve. Lejimi i kësaj kostoje në RAB do të nënkuptonte që KOSTT-i do të mblidhte edhe një herë koston e zhvlerësimit të këtyre aseteve për tërë jetëgjatësinë e tyre, edhe pse këtë shumë të të hollave KOSTT-i e ka pranuar në kuadër të shpenzimeve operative të të Hyrave të Lejuara në SHTE3.

### **5.3 Niveli i kostove të KOSTT-it në raport me operatorët e tjerë në regjion**

Në fund të komenteve të tyre, KOSTT-i ka ofruar një analizë me të cilën ka dashur të potencojë faktin se të hyrat e KOSTT-it përbëjnë vetëm 6% të të Hyrave të përgjithshme të sektorit, kur merren parasysh edhe subvencionet e pranuar nga KEK-u.

ZRrE-ja konsideron që, meqenëse struktura e sistemit elektroenergjetik dhe struktura e çmimeve dhe tarifave mund të ndryshojë nga vendi në vend, një krahasim i tillë nuk është koherent.

## **6 Komentet e Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave**

Përmes një shkrese të dërguar në ZRrE, Ministria e Ekonomisë dhe e Financave është shprehur se është “qëllimi i Qeverisë që të zvogëlojë ndarjet buxhetore për importin e energjisë për vitin 2010 nga 40 milion euro në 30 milion euro.” Sipas kësaj shkrese, subvencionet qeveritare do të vazhdojnë të ulen edhe në vitet e ardhshme dhe parashihet që të eliminohen deri në vitin 2013. Po ashtu, MEF-i thekson se tarifat për konsumatorët e energjisë duhet të ndryshojnë në mënyrë që të reflektojnë koston reale të shërbimit me energji elektrike dhe ngritjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara.

ZRrE-ja ka parasysh nevojën për përmirësim të mëtutjeshëm të shërbimeve të energjisë elektrike. Në këtë drejtim, duke pasur parasysh nevojën për investime kapitale në sektorin e energjisë elektrike në Kosovë, ZRrE-ja ka pranuar të lejojë kthim të lejuar dhe zhvlerësim për të gjitha investimet kapitale të propozuara nga të licencuarit.

Aplikacioni i KEK-ut për tarifën e vitit 2010 ka përmbajtur vlerën e subvencioneve prej 50 milion euro, prej të cilave 40 milion janë të paraqitura në buxhetin tashmë të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe pjesa tjetër (10 milion euro) është teprica e bartur nga subvencionet e vitit 2009. ZRrE-ja, gjatë përcaktimit të tarifave, bazohet në dokumentet që aktualisht janë në fuqi. Andaj, ZRrE e merr në konsiderim nivelin e subvencioneve, siç janë të paraqitura edhe në Raportin Konsultativ.

## **7 Komentet e Shoqatës së Ujësjetësve të Kosovës (SHUKOS)**

SHUKOS-i ka kundërshtuar ngritjen e mundshme të tarifave të energjisë elektrike, duke theksuar gjendjen e rëndë financiare të Kompanive Publike të Ujësjetësve të Kosovës. SHUKOS-i ka theksuar se i është drejtuar disa herë ZRrE-së dhe KEK-ut për mundësinë e krijimit të një tarife të veçantë për ujësjetësit.

ZRrE-ja thekson se, për krijimin e një kategorie të veçantë të konsumatorëve, SHUKOS-i duhet të drejtohet në KEK të cilët janë të obliguar të propozojnë ndryshim në strukturë tarifore, nëse mund të dëshmohet se profili i ngarkesës së Ujës-jellësve ndryshon nga profili i ngarkesës së kategorisë të cilës ata tani i përkasin.

ZRrE-ja do të shqyrtonte dhe aprovonte një strukturë të përshtatshme tarifore, të propozuar nga KEK-u nga e cila do të përfitonin edhe konsumatorët edhe kompania e licencuar.

## **8 Komentet e Shoqërisë Civile**

Organizatat Jo-Qeveritare “Konsumatori” dhe “Fol” janë shprehur në mënyrë të përgjithshme kundër rritjes së tarifave të energjisë elektrike.

Komentet e këtyre organizatave nuk kanë ofruar ndonjë fakt të ri që do të ndryshonte propozimin e ZRrE-së në Raportin Konsultativ.

## **9 Propozimet e ZRrE-së**

Bazuar në arsyetimet dhe shpjegimet e dhëna më lart, ZRrE-ja nuk ka marrë ndonjë koment i cili do të ndikonte në ndryshimin e propozimit të ZRrE-së të paraqitur në Raportin Konsultativ.

Prandaj ZRrE-ja propozon që niveli i të Hyrave të Lejuara të KEK-ut për vitin 2010 të jenë 156.4 milion euro ndërkaq për KOSTT-in të jenë 18.1 milion euro. Ky nivel i të Hyrave të Lejuara për të dy ndërmarrjet e licencuara mund të mblidhet me nivelin e tanishëm të tarifave. Së këndejmi, ZRrE propozon që tarifat e rregulluara me pakicë ekzistuese të mbesin në fuqi edhe për këtë periudhë tarifore.

Niveli i tarifave të rregulluara me pakicë që do të mbesin në zbatim është dhënë në Aneksin 1.

Niveli i ngarkesave të propozuara që reflektojnë të Hyrat e Lejuara për KOSTT-in është dhënë në Aneksin 2.

ZRrE-ja falënderon të gjitha palët e interesit për komentet e dërguara dhe për pjesëmarrjen aktive të tyre gjatë këtij shqyrtimi tarifor.

## 9.1 Aneksi 1: Tarifat e Rregulluara me pakicë

Grupi Tarifor	Niveli i tensionit të furnizimit	Elementi Tarifor	Njësia	Koha gjatë ditës	Të tanishme		Të propozuara	
					Sezoni I Lartë	Sezoni I ulët	Sezoni I Lartë	Sezoni I ulët
					1 tetor - 31 mars	1 prill - 31 shtator	1 tetor - 31 mars	1 prill - 31 shtator
0	110kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		83.83		83.83	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		5.59	5.59	5.59	5.59
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	6.49	1.92	6.49	1.92
			€/kWh	Tarifë e Ulët	2.70	1.58	2.70	1.58
		Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0.00	0.00	0.00	0.00
1	35kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		11.08		11.08	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		5.81	5.81	5.81	5.81
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	6.79	2.94	6.79	2.94
			€/kWh	Tarifë e Ulët	3.59	2.65	3.59	2.65
		Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0.66	0.66	0.66	0.66
2	10kV	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		4.58		4.58	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		5.01	5.01	5.01	5.01
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	7.61	3.39	7.61	3.39
			€/kWh	Tarifë e Ulët	4.10	3.09	4.10	3.09
		Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0.66	0.66	0.66	0.66
3	0.4 kV Kategoria I (konsumatorët e mëdhenj të energjisë reaktive)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2.58		2.58	
		Fuqia e angazhuar	€/kW		2.91	2.91	2.91	2.91
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Lartë	8.45	4.69	8.45	4.69
			€/kWh	Tarifë e Ulët	5.33	4.43	5.33	4.43
		Energjia reaktive (Q)	€/kVArh		0.66	0.66	0.66	0.66
4	0.4kV Kategoria II	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2.92		2.92	
		Energjia aktive (P)	€/kWh	Tarifë e vetme	10.41	6.73	10.41	6.73
			€/kWh	Tarifë e Lartë	12.53	8.21	12.53	8.21
		Energjia aktive (P), prej së cilës	€/kWh	Tarifë e Ulët	6.26	4.10	6.26	4.10
5	0.4kV matësi 2 tarifor (2-vlerësh, shtëpiak)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2.08		2.08	
		Energjia aktive (P) për konsum:						
		<200kWh/muaj (Blloku i parë):	€/kWh	Tarifë e Lartë	4.64	3.33	4.64	3.33
			€/kWh	Tarifë e Ulët	2.33	1.66	2.33	1.66
		200-600kWh/muaj (Blloku i dytë):	€/kWh	Tarifë e Lartë	6.43	4.60	6.43	4.60
			€/kWh	Tarifë e Ulët	3.22	2.31	3.22	2.31
		>600 kWh/muaj (Blloku i Tretë):	€/kWh	Tarifë e Lartë	9.33	6.68	9.33	6.68
			€/kWh	Tarifë e Ulët	4.66	3.35	4.66	3.35
6	0.4kV matësi 1 tarifor (1-vlerësh, shtëpiak)	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2.08		2.08	
		Energjia aktive (P) për konsum:						
		<200kWh/muaj (Blloku i parë):	€/kWh	Tarifë e vetme	4.14	2.96	4.14	2.96
		200-600kWh/muaj (Blloku i dytë):	€/kWh	Tarifë e vetme	5.73	4.10	5.73	4.10
>600 kWh/muaj (Blloku i Tretë):	€/kWh	Tarifë e vetme	8.31	5.96	8.31	5.96		
7	0.4kV (shtëpiak pa matës)	Konsumi i vlerësuar:						
		<200 kWh/muaj	€/konsumator/muaj		21.50		21.50	
		200-600 kWh/muaj	€/konsumator/muaj		38.92		38.92	
>600 kWh/muaj			65.58		65.58			
8	Ndriçim publik	Tarifa fikse e konsumatorit	€/konsumator/muaj		2.92		2.92	
		Energjia aktive (P) për konsum:	€/kWh	Tarifë e vetme	8.42	8.42	8.42	8.42

Tarifa e lartë aplikohet prej orës 07:00 - 22:00 gjatë sezonit të lartë dhe prej orës 08:00 - 23:00 gjatë sezonit të ulët.  
Konsumatori ngarkohet me energji reaktive mbi atë të lejuarën që korrespondon me  $\cos(\Phi)=0.95$

## 9.2 Aneksi 2: Ngarkesat e KOSTT-it

Grupi Tarifor	Niveli i tensionit të lidhjes	Elementi Tarifor	Njësia	Të tanishme	Të propozuara
Gjenerimi	400kV / 220kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/kW/vit	0.000	0.000
		Tarifa për Operim të Sistemit	€/MWh	1.067	0.934
		Tarifa për Operim të Tregut	€/MWh	0.020	0.018
Gjenerimi	110kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/kW/vit	0.000	0.000
		Tarifa për Operim të Sistemit	€/MWh	1.067	0.934
		Tarifa për Operim të Tregut	€/MWh	0.020	0.018
Gjenerimi	Distribucioni	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/kW/vit	0.000	0.000
		Tarifa për Operim të Sistemit	€/MWh	0.328	0.287
		Tarifa për Operim të Tregut	€/MWh	0.020	0.018
Furnizimi	400kV / 220kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/kW/vit	4.636	4.057
		Tarifa për Operim të Sistemit	€/MWh	1.067	0.934
		Tarifa për Operim të Tregut	€/MWh	0.020	0.018
Furnizimi	110kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/kW/vit	10.094	8.832
		Tarifa për Operim të Sistemit	€/MWh	1.067	0.934
		Tarifa për Operim të Tregut	€/MWh	0.020	0.018